

RELACION TEKNIK

MBI PUNIMET GJEODEZIKE DHE TOPOGRAFIKE


- Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin : Rehabilitimi i sheshit perpara pallateve 645/1, 645/3 dhe 645/4, ne lagjen "Vullnetari", Elbasan. U krye mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Sektori dhe Azhornimit Topografik organizoj punen dhe kryeu punimet ne baze te pervojave se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjitha projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shtetror me sistemin nderkombetar te projekcionit (UTM) me ellipsoid WGS84 dhe kuota . Para fillimit te rilevimit u krye njohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren u paisen me koordinata ne projeksinin UTM dhe kuota .

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me kunja hekuri me gjatesi 30 - 40 cm te futur toke. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje blu te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, kane pamje te ndersjellte, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e sistemimit te rruges dhe ne ate te zbatimit te saj.





Çdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perfthuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrit e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e rruges ekzistuese te projektit. Matjet u kryen me mates GPS "SinoGNSS"

Rilevimi i brezit



Duke u mbështetur në pikat e poligonometrise dhe të nivelimit gjeometrik u zhvillua rrjeti i matjeve topografike të planimetrise në objektin : Rehabilitimi i sheshit përpara pallateve 645/1, 645/3 dhe 645/4, në lagjen "Vullnatori", Elbasan. Në përcaktimin e relievit jemi bazuar kryesisht në zonat ku kanë ndryshime të terrenit ekzistues në përputhje me kërkesat e përgjithshme dhe specifike teknike të hartimit të projektit.

Eshtë rilevuar çdo objekt në afërsi të zonës si rrugë, perrua, skarpitet anësorë, ura, tombino, ndërtesa, mure, mure mbajtës, gardhe, objekte të ndryshme, shtylla tensioni, rrugë dytesore etj. Objektet e parë në terren janë hedhur në reliev të gjithë. Punimet topogjeodezike të kryera janë mbështetur në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Çdo pikë e marrë në terren ka koordinata tre dimensionale, të paraqitura në projekt.

	X	Y	Z	Code
1	422344.9560	4552667.1660	147.52	st1
2	422356.0647	4552577.8910	145.63	st2

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin AUTOCAD CIVIL & PLATEIA CGS 2009 . Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e fiksimeve dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijuan 5 pika te forta te cilat jane te mjaftueshme per kryerjen e pikave detaje te rilevimit .

Grupi Punes

Pergjegjese S.A.T : ing .Elior Mihali

Specialiste :ing .Fatjona Boja

Konceptoi : Klara Sharra

